

ALBAWINGS Sh.p.k

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2016**

**me opinionin e audituesit të pavarur
bashkëngjitur**

| | |
|---|----|
| Pëmbajja | |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 1 |
| PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE | 2 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL | 3 |
| PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE..... | 4 |
| 1. Informacion i pergjithshem | 5 |
| 2. Permbledhje e politikave kryesore kontabel..... | 5 |
| 3. Politikat kontabel..... | 6 |
| 4. Mjete monetare | 9 |
| 5. Llogari te arketueshme tregtare..... | 9 |
| 6. Te tjera llogari te arketueshme | 9 |
| 7. Inventarë | 10 |
| 8. Parapagime dhe shpenzime te shtyra | 10 |
| 9. Aktive afatgjate materiale dhe jomateriale..... | 10 |
| 10. Llogari të pagueshme tregtare..... | 11 |
| 11. Palet e lidhura | 11 |
| 12. Detyrime tatimore..... | 12 |
| 13. Te tjera detyrime..... | 12 |
| 14. Hua afatgjate | 12 |
| 15. Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit | 12 |
| 16. Lenda e pare dhe sherbimet e konsumueshme | 13 |
| 17. Te tjera shpenzime | 13 |
| 18. Shpenzime te personelit | 13 |
| 19. Tatimi mbi fitimin | 14 |
| 20. Angazhime dhe pasiguri | 14 |
| 21. Ngjarje te mepashme..... | 14 |



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për ortakët e shoqërisë Albawings shpk,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Albawings shpk (më poshtë “Shoqëria”) që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2016, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 5 deri në faqen 14.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Albawings shpk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2016, të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur dhe ndryshimeve në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në paragrafin **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare** të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standarteve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi I BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

TPA Albania shpk
Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania
www.tpa-group.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimit apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijmësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijmësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijmësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijmësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Albawings sh.p.k, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 26 Prill 2017



Ilir Binaj CPA, CGMA, Auditor Ligjor



TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia


ALBAWINGS SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR****Më 31 dhjetor 2016**

| | Shënime | 31 Dhjetor 2016 | 31 Dhjetor 2015 |
|--|---------|----------------------|-------------------|
| Aktive afatshkurtra | | | |
| Mjete monetare | 4 | 42,341,678 | 31,861,821 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 5 | 1,446,415 | - |
| Të tjera llogari të arkëtueshme | 6 | 3,529,126 | 678,216 |
| Inventarë | 7 | 4,163,550 | - |
| Parapajime dhe shpenzime të shtyra | 8 | 70,986,007 | 1,098,240 |
| Total Aktive Afatshkurtra | | 122,466,776 | 33,638,277 |
| Aktivet afatgjata | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 9 | 822,622 | 296,384 |
| Aktive afatgjata jomateriale | 9 | 10,015,511 | - |
| Total aktive afatgjata | | 10,838,133 | 296,384 |
| Total Aktive | | 133,304,909 | 33,934,661 |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrime afatshkurtra | | | |
| Llogari të pagueshme tregtare | 10 | 110,138,777 | 168,072 |
| Te tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 11 | 13,685,276 | - |
| Detyrime tatimore | 12 | 2,424,991 | 154,727 |
| Të tjera detyrime | 13 | 67,275,216 | 590,061 |
| Total Detyrime afatshkurtra | | 193,524,260 | 912,860 |
| Detyrime afatgjata | | | |
| Hua afatgjate | 14 | 40,569,000 | 27,456,000 |
| Total Detyrime afatgjata | | 40,569,000 | 27,456,000 |
| Totali i detyrimeve | | 234,093,260 | 28,368,860 |
| Kapitali | | | |
| Kapitali i nënshkruar | | 14,029,000 | 14,029,000 |
| Humbje të mbartura | | (8,463,199) | - |
| Humbja e ushtrimit | | (106,354,152) | (8,463,199) |
| Total kapitali themeltar | | (100,788,351) | 5,565,801 |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | | 133,304,909 | 33,934,661 |

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë aprovuar nga drejtimi dhe nëshkruar në emër të tij me 28 mars 2017 nga:

Administrator

Dhimiter TOLA





ALBAWINGS SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

| | Shenime | 31 Dhjetor 2016 | 31 Dhjetor 2015 |
|---|---------|----------------------|--------------------|
| Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit | 15 | 649,956,084 | - |
| Te ardhura te tjera te shfrytezimit | 15 | 45,313,071 | (157,159) |
| Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme | | (732,272,329) | (5,846,249) |
| Lenda e pare dhe materiale te | | | |
| 1) konsumueshme | 16 | (678,223,940) | - |
| 2) Te tjera shpenzime | 17 | (54,048,389) | (5,846,249) |
| Shpenzime te personelit | 18 | (68,316,959) | (2,444,191) |
| 1) Paga dhe shperblime | | (63,242,681) | (2,283,328) |
| Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension) | | (5,074,278) | (160,863) |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 9 | (1,034,019) | (15,600) |
| Te ardhura te tjera | | - | - |
| Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve te mbajtura si aktive afatshkurtra | | - | - |
| Shpenzime financiare | | - | - |
| Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet | | | |
| Fitimi/humbja para tatimit | | (106,354,152) | (8,463,199) |
| Shpenzimi i tatimit mbi fitimin | 19 | - | - |
| 1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | - | - |
| Fitimi/humbja e vitit | | (106,354,152) | (8,463,199) |
| Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin: | | - | - |
| Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin | | - | - |
| Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin | | (106,354,152) | (8,463,199) |

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBAWINGS SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

| | Kapital themeltar | Humbja e akumuluar | Totali |
|-----------------------------------|----------------------|-----------------------|----------------------|
| Gjendja më 1 janar 2015 | - | - | - |
| Kapitali themeltar | 14,029,000 | - | 14,029,000 |
| Humbja e periudhes | - | (8,463,199) | (8,463,199) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | 14,029,000 | (8,463,199) | 5,565,801 |
| Humbja e periudhes | - | (106,354,152) | (106,354,152) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 14,029,000 | (114,817,351) | (100,788,351) |

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBAWINGS SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE**
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

| | Shenime | 31 Dhjetor 2016 | 31 Dhjetor 2015 |
|---|---------|---------------------|--------------------|
| Flukset e parasë nga aktivitetet operative | | | |
| Fitim / (humbja) e vitit | | (106,354,152) | (8,463,199) |
| Rregullimet për shpenzimet jomonetare: | | | |
| Shpenzimet financiare jomonetare | 15 | 887,639 | 157,159 |
| Shpenzime konsumi dhe amortizimi | 9 | 1,034,019 | 15,600 |
| Rënie/(ritje) në llogari të arkëtueshme tregtare | 5 | (1,446,415) | - |
| Rënie/(ritje) në të tjera llogari të arkëtueshme | 6 | (2,850,910) | (678,216) |
| Rënie/(ritje) në inventarë | 7 | (4,163,550) | - |
| Rënie/(ritje) në parapagime dhe shpenziem të shtyra | 8 | (69,887,767) | (1,098,240) |
| Rritje/(rënie) në llogari te pagueshme tregtare | 10 | 109,970,705 | 168,072 |
| Rritje/(rënie) në të tjera te pagueshme | 11 | 13,685,276 | - |
| Rritje/(rënie) në detyrime tatimore | 12 | 2,270,264 | 154,727 |
| Rritje/(rënie) në të tjera detyrime | 13 | 66,685,155 | 590,061 |
| Mjete monetare neto nga/ (përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit | | 9,830,367 | (9,154,036) |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit | | | |
| Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale | 9 | (11,575,768) | (311,984) |
| Mjete monetare neto nga/ (përdorur në) aktivitetin e investimit | | (11,575,768) | (311,984) |
| Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit | | | |
| Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar | | - | 14,029,000 |
| Hua të arkëtuara | 14 | 13,835,000 | 28,084,000 |
| Mjete monetare neto nga/ (përdorur në) aktivitetin e financimit | | 13,835,000 | 42,113,000 |
| Rritje/ (rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare | | 12,089,599 | 32,646,980 |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar | 4 | 31,861,821 | - |
| <i>Efekti i llogaritjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i> | | (1,609,742) | (785,159) |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor | 4 | 42,341,678 | 31,861,821 |

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 21 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria ALBAWINGS Sh.p.k. (me poshte referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 18 shkurt 2015 dhe prane Deges se Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L51418010M. Shoqeria zoterohet nga ortakët, shoqeria Travel Hub Solution 49%, Gentjan Kole 41 %, dhe Dhimiter Tola 10% secili ne kapitalin e Shoqerise.

Me 31 dhjetor 2016, vlera e kapitalit themeltar, eshte 14,029,000 Leke, e ndare ne 3 kuota sipas perqindjeve 49%,41%,10%.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet ne perputhje me dispozitat perkatese te Ligjit 9901, date 14 prill 2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte: Ushtrimi i aktivitetit te linjave ajrore per transportin e personave, mallrave dhe postes, jo vetem me udhetime te linjes por edhe me udhetime jot e linjes (charter). Blerjen, shitjen, dhenien me qera dhe zhvillimin e pasurive te paluajtshme, veprime logjistike dhe cdo aktivitet tregtar te lidhur me to, marrjen dhe dhenien e huave, vendosjen e hipotekave pengjeve dhe cdo aktivitet tjetër te lejuar nga legjislacioni shqiptar.

Me 04 maj 2016 ortakët i shoqerise Open Sky B.V qe zoteronte 80% te kuotave ka shitur nje pjese te kuotave te tij ne shoqerine Albawings tek ortakët Gentjan Kole duke shkuar ne kuoten prej 49%.

Open Sky B.V me 20 dhjetor 2016 ka shitur te gjithë pjesen e mbetur te kuotave qe zoteronte ne shoqerine Albawings tek ortakët Travel Hub Solutions.

Administratori i Shoqerise eshte Z. Dhimiter Tola
Selia kryesore e Shoqerise ndodhet ne Sheshi Skenderbej, Pall. Kultures, kati I, Tirane.
Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2016 eshte 56 (31 dhjetor 2015: 5).

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006, te permiresuara dhe te detyrueshme per zbatim per vitin financiar qe fillon me 01 janar 2015, ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" te ndryshuar, me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike me perjashtim te rasteve kur percaktohet ndryshe, nese ka te tilla.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare te jane prezantuar ne Leke, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente gjate periudhes per te cilen jane pergatitur keto pasqyra financiare, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit mesatar ne muajin e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2015 jane:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|-----------------------|-----------------|-----------------|
| Leke/Euro | 135.23 | 137.28 |
| Leke/Dollare Amerikan | 127.18 | 125.79 |

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare dhe llogari te pagueshme dhe qeraja financiare.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitetit financiar ose kur Shoqeria transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne llogarite rrjedhese dhe parane e gatshme ne arke.

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogaritë të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejte dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Qeraja financiare

Qeraja financiare paraqitet me vlerën e tyre të drejte dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta të tjera joderivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale dhe jomateriale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zera të ndryshme (komponentet me të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një AAJM e blerë matet fillimisht me koston që përbëhet nga çmimi i blerjes dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me blerjen. Një AAJM do të paraqitet në bilanc me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Rivlerësimi i AAJM-së nuk lejohet.

Kostot e mëparmshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zeri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabel të atij zeri nëse është e mundur që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marrë për bazë jetën e dobishme të aktivit duke filluar nga dita kur ai është i gatshëm për përdorim. Toka nuk amortizohet.

Për amortizimin e AAJM-së të amortizueshme do të përdoret metoda lineare, përveç rasteve kur një metodë tjetër siguron një pamje më objektive të përfitimeve të pritshme ekonomike nga ky aktiv gjatë jetës së dobishme të tij.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Metodatat e amortizimit dhe përqindjet perkatese sipas grupeve të aktiveve afatgjata për periudhën aktual janë si më poshtë:

| | |
|--------------------------|------------------------------|
| Mjete transporti | 20% mbi vlerën kontabel neto |
| Instalime teknike | 20% mbi vlerën kontabel neto |
| Pajisje informatike | 25% mbi vlerën kontabel neto |
| Mobilje dhe pajisje zyre | 20% mbi vlerën kontabel neto |
| Licenca | 15% mbi vlerën kontabel neto |

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.4 Zhvleresimi

Aktivitet financiar

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuara, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rendesishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar të disponueshëm për shitje i njohur me pare në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitet jofinanciar

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalese parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjale.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrese bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në sajë të kontributeve të ortakëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejte të shumës së arketuar apo të arketueshme nga shitja e mallrave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet, nëse ka.

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në varesi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostovë perkatëse.

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare përfshijnë fitimet nga kursi i kembimit që njihen në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe te ardhura të tjera nga interesat e llogarive rrjedhese apo depozitave. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për qerane financiare, humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet në vlerën e drejte të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nepermjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse që Shoqëria ka me bankat në Shqipëri si dhe paraja në arke në valute dhe në monedhe vendase. Më poshtë po ju japim një detajim të llogarive me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|----------------------------------|-------------------|-------------------|
| Para në bankë në monedhe të huaj | 42,217,234 | 31,725,809 |
| Para në bankë në monedhe vendase | 99,356 | 126,947 |
| Para në arke në monedhe të huaj | 25,081 | 8,374 |
| Para në arke në monedhe vendase | 7 | 691 |
| Totali | 42,341,678 | 31,861,821 |

5. LLOGARITË ARKETUESHME TREGTARE

Llogaritë e arketueshme përbehen nga vlerat e të drejtave të Shoqërisë ndaj të tjerëve të cilët nuk kanë shlyer ende detyrimin deri në datën e ndertimit të pasqyrave financiare. Me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajimet përse i përket klienteve me të mëdhenj paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|-----------------------|------------------|-----------------|
| Alisud S.p.A | 141,936 | - |
| Avioalb Services Shpk | 1,304,479 | - |
| Totali | 1,446,415 | - |

6. TË TJERA LLOGARITË ARKETUESHME

Llogaritë e tjera të arketueshme përbehen nga paradhenie ndaj personelit dhe vlerën kreditore të TVSH-së dhe të tatimit fitimit të cilat përketesisht me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---------------------------|------------------|-----------------|
| TVSH e arketueshme | 2,639,354 | 678,216 |
| Paradhenie për punonjesit | 650,000 | - |
| Tatim mbi Fitimin | 239,772 | - |
| Totali | 3,529,126 | 678,216 |

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. INVENTARË

Me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 inventari i shoqërisë përbehet nga karburanti në serbatoret e avioneve dhe nga inventari i imet të cilet paraqiten si më poshte:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|--------------------------------------|------------------|-----------------|
| Karburant për avione - lende djegese | 517,348 | - |
| Uniforma stafi i operimit | 3,646,202 | - |
| Totali | 4,163,550 | - |

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Llogaria e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshte:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|--|-------------------|------------------|
| Parapagime furnitoresh | 16,000,690 | 1,098,240 |
| Parapagime implementimi i Sistemit IFLYres | 7,654,597 | - |
| Deposita Alitalia | 135,230 | - |
| Deposita Cardiff Aviation Malta | 13,523,000 | - |
| Deposita Texas Aviation Group | 17,943,800 | - |
| Deposita DISTAL S.r.l | 6,761,500 | - |
| Shpenzime të shtyra | 8,967,190 | - |
| Totali | 70,986,007 | 1,098,240 |

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

Aktivët afatgjatë materiale dhe jomateriale me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 përbehen si më poshte:

| Kosto | Paisje informatike | Licensa | Totali |
|-----------------------------------|--------------------|-------------------|--------------------|
| Gjendja më 01 janar 2015 | - | - | - |
| Shtesa | 311,984 | - | 311,984 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | 311,984 | - | 311,984 |
| Shtesa | 643,651 | 10,932,117 | 11,575,768 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 955,635 | 10,932,117 | 11,887,752 |
| Amortizimi dhe zhvlerësimi | | | |
| Gjendja më 01 janar 2015 | - | - | - |
| Shpenzimi i periudhës | (15,600) | - | (15,600) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | (15,600) | - | (15,600) |
| Shpenzimi i periudhës | (117,413) | (916,606) | (1,034,019) |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | (133,013) | (916,606) | (1,049,619) |
| Vlera kontabël neto | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 2015 | 296,384 | - | 296,384 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2016 | 822,622 | 10,015,511 | 10,838,133 |

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Llogari të pagueshme tregtare me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|--------------------|-----------------|
| Distal s.r.l. | 38,368,682 | - |
| Eurocontrol | 13,266,755 | - |
| Texas Aviation Group LLC | 8,971,900 | - |
| Aerdorica S.p.A | 5,238,276 | - |
| ENI S.p.A | 4,389,682 | - |
| Toscana Aeroporti S.p.A | 3,366,240 | - |
| SASE S.p.a | 3,156,071 | - |
| Airiminum 2014 S.p.A | 2,971,579 | - |
| IBS Software Europe Ltd | 2,848,222 | - |
| Aeroporti Valerio Catullo Di Verona Villafranca S.p.A | 2,787,296 | - |
| Avioalb Services | 1,588,953 | - |
| iFLY shpk | 347,730 | 24,811 |
| QTZHK shpk | 190,535 | 68,640 |
| Sky Hotel shpk | 100,361 | 49,891 |
| Te tjere furnitore | 15,635,964 | 24,731 |
| Furnitore fatura te pamberritura | 6,910,531 | - |
| Totali | 110,138,777 | 168,072 |

11. PALET E LIDHURA

Detyrimet dhe te drejtat dhe shpenzimet dhe te ardhurat me palet e lidhura per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si me poshte:

| Te tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|--|-------------------|-----------------|
| Avioalb Services | 13,523,000 | - |
| Dhimiter Tola | 162,276 | - |
| Totali | 13,685,276 | - |

| Llogari të arketueshme tregtare | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---------------------------------|------------------|-----------------|
| Avioalb Services (shenimi 5) | 1,304,479 | - |
| Totali | 1,304,479 | - |

| Llogari të pagueshme tregtare | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|-------------------------------|------------------|-----------------|
| Avioalb Services (shenimi 10) | 1,588,953 | - |
| iFLY shpk | 347,730 | - |
| Spirit Travel & Tours | 339,170 | - |
| Totali | 2,275,853 | - |

| Te ardhura nga palet e lidhura | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|--------------------------------|------------------|-----------------|
| Avioalb Services | 2,662,207 | - |
| Totali | 2,662,207 | - |

| Shpenzime nga palet e lidhura | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|-------------------------------|------------------|-----------------|
| Avioalb Services | 2,092,404 | - |
| iFLY shpk | 1,050,861 | - |
| Spirit Travel & Tours | 4,170,552 | - |
| Totali | 7,313,816 | - |

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore të shoqërisë me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|-------------------------------------|------------------|-----------------|
| Tatim mbi të ardhurat personale | 1,202,805 | 83,258 |
| Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 1,144,046 | 71,469 |
| Tatim në turrim | 78,140 | - |
| Totali | 2,424,991 | 154,727 |

13. TE TJERA DETYRIME

Te tjera detyrime të shoqërisë me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 janë si poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|-----------------------------------|-------------------|-----------------|
| Paga e shpërblime | 7,670,025 | 590,061 |
| Deposit BV On board Contract | 1,622,760 | - |
| Parapagime kliente, Blue Panorama | 57,982,431 | - |
| Totali | 67,275,216 | 590,061 |

14. HUA AFATGJATE

Huaja afatgjate është një hua e mare nga Open Sky B.V, shoqëri e themeluar në Hollandë dhe aksionere e shoqërisë Albawings shpk deri në dhjetor 2016. Vlera e huasë është 300,000 EUR (31 dhjetor 2015: 200,000 EUR) ose ekuivalentja në leke prej 40,569,000 leke (31 dhjetor 2015: 27,456,000 leke).

15. TE ARDHURAT NGA AKTIVITETI I SHFRYTEZIMIT

Shoqëria gjeneron të ardhura nga fluturimet e linjave ajrore, fluturimet charter, shitjen e biletave, kontratat CODESHARE, etj. Një rakordim i të ardhurës neto të Shoqërisë jepet si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|--------------------|------------------|
| Rakordimi i të ardhurave me FDP-ne | | |
| Qarkullimi i tatueshem | 675,664,080 | - |
| Te ardhura të Netuara | (279,791) | - |
| Te ardhura nga incentiva të perfituara | 30,561,980 | - |
| Shpenzime të rifaturuara | (11,564,753) | - |
| Humbje nga kursi i kembimit | 887,639 | (157,159) |
| Shuma e qarkullimit të korrigjuar | 695,269,155 | (157,159) |
| Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 649,956,084 | - |
| Te ardhura të tjera të shfrytëzimit | 45,313,071 | (157,159) |
| Totali i të ardhurave | 695,269,155 | (157,159) |
| Diferenca | - | - |

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

16. LENDA E PARE DHE SHERBIMET E KONSUMUESHME

Sherbimet e konsumueshme me 31 dhjetor 2016 paraqiten si me poshte:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|--------------------|-----------------|
| Shpenzime karburanti avione | 128,749,733 | - |
| Shpenzime tarifa aeroportuale pasagjere | 113,302,688 | - |
| Qera perdorim motore | 77,588,000 | - |
| Tarifa e kalimit te kufirit | 61,794,050 | - |
| Sherbime ground handling | 59,274,163 | - |
| Tarifa Enroute & Terminal | 45,300,981 | - |
| Qera perdorim avione | 33,314,596 | - |
| Shpenzime Landing & Take off | 29,294,335 | - |
| Mirembajtje dhe riparime avion | 25,710,703 | - |
| Shpenzime fluturime ACMI | 20,275,889 | - |
| Pool components (Mirembajtje) | 15,267,507 | - |
| Sherbime navigacionale | 10,464,443 | - |
| Te tjera shpenzime operationale direkte | 57,886,853 | - |
| Totali | 678,223,940 | - |

17. TE TJERA SHPENZIME

Shpenzimet administrative per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 perbehen si me poshte:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|---|-------------------|------------------|
| Dieta personeli | 10,109,583 | - |
| Transferime, udhetim, dieta | 7,208,221 | 761,370 |
| Shpenzime akomodimi | 6,531,231 | 149,829 |
| Sherbime konsulence teknike | 4,410,045 | 2,205,216 |
| Shpenzime dokumenta teknike motoreve | 3,348,767 | - |
| Shpenzime per licencen e aviacionit civil | 2,879,619 | 508,200 |
| Shpenzime te tjera | 2,388,206 | - |
| Qira per zyra | 2,196,848 | 629,057 |
| Shpenzime per trajnime | 2,078,619 | 1,342,695 |
| Shpenzime regjistrim avioni | 1,827,518 | - |
| Sherbime transferta bankare | 1,570,843 | 48,519 |
| Shpenzime simulatori | 1,431,654 | - |
| Te tjera administrative | 8,067,235 | 201,363 |
| Totali | 54,048,389 | 5,846,249 |

18. SHPENZIME TE PERSONELIT

Shpenzime e punonjesve me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 jane si me poshte:

| | 31 dhjetor 2016 | 31 dhjetor 2015 |
|--|-------------------|------------------|
| Paga dhe shperblime | 63,242,681 | 2,283,328 |
| Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore | 5,074,278 | 160,863 |
| Totali | 68,316,959 | 2,444,191 |

ALBAWINGS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

19. TATIMI MBI FITIMIN

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme për tatimin mbi fitimin për periudhën 2016 është 15%.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi janë vetedeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojnë vlerësimin final.

Shoqëria për vitin 2016 rezultoi me humbje si për qëllime kontabile ashtu dhe për qëllime fiskale. Një rikonsilim i tatimit paraqitet si më poshtë:

| | <u>31 Dhjetor 2016</u> | <u>31 Dhjetor 2015</u> |
|--|-----------------------------|---------------------------|
| <i>Humbja para tatimit</i> | (106,354,152) | (8,463,199) |
| Shpenzime të panjohura të tjera | <u>2,961,042</u> | <u>852,960</u> |
| <i>Humbja fiskale (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i> | (103,393,110) | (7,610,239) |
| Humbje fiskale e mbartur | (7,610,239) | - |
| Humbja fiskale për tu mbartur në vitet pasardhëse | (111,003,349) | (7,610,239) |
| <i>Tatim fitimi 15%</i> | - | - |
| Fitimi Neto | <u>(106,354,152)</u> | <u>(8,463,199)</u> |

20. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga pale të treta. Me 31 dhjetor 2016, Shoqëria nuk ka çështje të cilat do të kenë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqëria ose ndryshime në aktivet neto të saj. Gjithashtu, me 31 dhjetor 2016, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

21. NGJARJE TË MEPASSHME

Nuk ka asnjë ngjarje të mepasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në keto pasqyra financiare.